



**Republika e Kosovës**  
**Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti shërbimeve këshillimore teknike  
Department of Technical and Advisory Services  
Departmend za tehničke i savjetodavne usluge



**Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës**  
**Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services**  
**Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova**

## **Krasitja e Pemëve!**

Te nderuar fermer,  
tani është koha për krasitjen e te gjitha llojeve te pemëve. Ju lutem shfrytëzoni maksimalisht kohen për krasitjen e pemëve ne përgjithësi se dikur behet vonë e efektet janë shumë me te vogla.

Sipas kohës kur kryhet krasitja kemi dy lloj krasitje:

1. Krasitja gjatë periudhës se qetësisë dimërore, dhe
2. Krasitja e gjelbër cila behet gjatë vegjetacionit,

Këtu do te sqarojmë krasitjen dimërore, çka është krasitja, pse dhe kur aplikohet.

Çka është krasitja,

Krasitja është një mase e rregullt vjetore e cila realizohet gjatë periudhës së qetësisë dimërore dhe gjatë vegjetacionit. Qëllimi i krasitjes është që të sigurohet mundësia e rritjes dhe e zhvillimit të degëzave me sytha prodhuese. Krasitjet e rregullta vjetore ndikojnë në rinovimin e vazhdueshëm të bimëve, si dhe siguron një ekuilibër ndërmjet rritjes vegjetative dhe asaj prodhuese.

Pra krasitja është **ARTI** i ndryshimit të mënyrës natyrore të rritjes së pemëve, në një rritje më të përshtatshme për të prodhuar na sasi dhe cilësi me te lart. Roli i krasitjes është shumë i madh dhe ndonjëherë edhe vendimtar për prodhimtarin e pemëve.



#### Pse dhe kur aplikohet krasitja.

Përmes krasitjes kryhet formimi i kurorës, eliminon prodhimin periodik të pemëve (siç ka qenë me parë një vit jep fruta një vit jo, përmes krasitjes mënjanohej kjo dukuri). Aplikimi i krasitjes rritë jetëgjatësinë e pemës, dhe eliminohen edhe degëzat. Përmes krasitjes rregullohet edhe depërtimi i rrezeve të diellit, pra ndriçimi më i mirë, ajrosja më e mirë. Kështu që me depërtim të rrezeve të diellit dhe ajrosjes më të mirë ka ndikim edhe në pengimin e zhvillimit të sëmundjeve të pemës. E krejt këta faktorë pastaj kanë ndikim në prodhimtari sasiore dhe cilësore.

Vendoset raport i drejtë i qarkullimit të materieve ushqyese ndërmjet sistemit rrënjor dhe atij mbitokësor si dhe ndërmjet pjesëve të veçanta të kurorës, duke bërë të mundur kështu shfrytëzimin e plotë të hapësirës që ka në dispozicion.

Krasitja e pemëve dimërore drufrutore aplikohet gjatë periudhës së qetësisë natyrore të pemës, (qetësisë dimërore), më mirë është të aplikohet pas periudhës kur pemët ju nënshtrohen temperaturave të ulëta, varësisht prej kushteve klimatike- temperaturave, muajt më të përshtatshëm për krasitje janë: **Shkurt – Mars**.

Pra fermeri të nderuar është koha për krasitje shfrytëzoni këtë masë shumë të rëndësishme për zhvillim dhe prodhimtari normale të kulturat pemëtarë



Për çdo këshillë apo sqarim rreth krasitjes dimërore apo këshillave tjera ne përgjithësi për bujqësi dhe zhvillim rural drejtohuni te këshilltaret e QKIK (qendrat këshilluese informative komunale) po ashtu ne QKIK mund te furnizoheni edhe me materiale te shtypura rreth nevojave te juaj.

**Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, MBPZHR**

**Rr. "Ukshin Hoti", ndërtesa e ish Ramiz Sadikut, nr 120 Kati III, Prishtinë – Kosova**

**Tel. 383- (0)3820038426**